

VENDIM
Nr. 561, datë 30.8.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN “NËNË TEREZA””, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.27/2014, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RESTAURIMEVE (KKR)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””, miratuar me vendimin nr.27/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, me një vlerë të përgjithshme 5 411 435 (pesë milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë, dhe për pasuritë ndërtim, me një vlerë të përgjithshme 30 695 749 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 36 107 184 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 30.8.2014.

6. Shpenzimet për botimet publike në gazeta, në masën 306 250 (treqind e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohen nga zëri “602” i aparatit të Ministrisë së Kulturës.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Bllokuar nga bankat”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE TE PALUAJTESHME PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER MARRJEN NE PERDORIM TE PERKOHSHEM PER INTERES PUBLIK, TE CILAT PREKEN NGA

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Siperfaqe		Çmimi Leke/m2		Vlera Leke			SHENIME
				Truall	Ndertim	Truall	Ndertim	Truallit	Ndertese	Banese	
1	FLUTURA HASAN CELA, LILJANA PETROR SOTIRI, NAZE HASAN SUBASHI, QEMAL GEGA, VJOLLCA NAGJELI SHTETI	8280	2/8-ND		104		12445.71		1,294,354		Plotesim dokumentacioni
2	HODO VELAJ SHTET	8160	7/11-N2		94.5		25769.97		2,435,262		Plotesim dokumentacioni
3	ROVAN LIMON LUKU	8280	2/327	72m2	299.8	23955	43894.79	1,724,760	13,159,659		Bllokuar ne favor te UNION BANK
4	PERSEFONI KRISTO KOKA	8280	2/13	51m2	60.9	23955	23944.33	1,221,705	1,458,210		Konfirmuar nga ZRVPP
5	MAJLINDA XHEVAHIR ZALLA VIPAUTO sh.p.k. VIPAUTO SH.P.K. LIONMAX KONSTRUKSION	8280	2/337 2/336 2/11 2/267	22.9m2 22.9m2 31.6m2 25.5m2	104.5	23955	65961.67	2,464,970	6,892,995		2/11 bllokuar ne favor te UNION BANK 2/336 Bllokuar ne favor te UNION BANK
6	MAK-ALBANIA sh.p.k. SHTET	8160	7/11-N3		140		34241.91		4,793,867		Plotesim dokumentacioni
7	LILJANA PETRO SOTIRI VJOLLCA RUSHIT ANGJELI FLUTURA HASAN CELA QEMAL LIAL GEGA SHTET	8280	2/334-ND/2	40m2	48.9		13525.6		661,402		Plotesim dokumentacioni
8											
9											
				-	852.6			5,411,435	30,695,749	-	36,107,184
	TOTALI					Leke					

